

Thirrje për dorëzimin e propozim-projekteve për organizimin e nismës evropiane për promovimin e leximit: "Dita e autorëve evropianë"

Pas dy edicioneve të para të suksesshme të nismës "Dita e autorëve evropianë" në 2023 dhe 2024, Komisioni Evropian ka shpallur thirrje për përzgjedhjen e një projekti që synon zhvillimin dhe organizimin e botimeve të ardhshme të "Ditës së autorëve evropianë", në vitin 2025, 2026 dhe 2027.

Me thirrjen, e cila u dedikohet organizatave nga sektori letrar, do të zgjidhet vetëm një projekt nga një konsorcium i përbërë nga të paktën dy organizata të pavarura nga dy vende të ndryshme pjesëmarrëse në Evropa Kreative. Aplikanti, përkatësisht koordinatori, duhet të jetë i regjistruar dhe aktiv së paku dy vjet para afatit për dorëzimin e aplikimit.

Buxheti i përgjithshëm i paraparë për bashkëfinancimin e projektit të përzgjedhur nga kjo thirrje arrin në 1.500.000 euro, me të cilat Bashkimi Evropian mbulon maksimum 80% të shpenzimeve të kualifikuara të projektit (me dinamikën e pagesës të parashikuar në draft marrëveshjen e grantit ).

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 10 shkurt 2025

### Qëllimet

Nisma "Dita e autorëve evropianë" synon të arrijë:

- Promovimi i diversitetit të letërsisë evropiane, nxitja e leximit dhe kultivimi i dashurisë për të lexuar tek brezat e rinj në vendet pjesëmarrëse në Evropën Kreative.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit arsimor (veçanërisht shkollave fillore dhe të mesme dhe mësuesve), sektorit letrar (autorë, përkthyes, botues, biblioteka dhe librari) dhe organizatave për promovimin e leximit në nivel lokal, kombëtar dhe evropian.
- Zhvillimi dhe zbatimi i një mekanizmi konkret për lehtësimin dhe mbështetjen financiare të takimeve dhe shkëmbimeve ndërmjet autorëve dhe të rinjve dhe/ose prindërve në shkolla, biblioteka, librari dhe vende të tjera.

### Prioritetet

Projektet duhet të propozojnë koncept që kombinon shënim njëditor të Ditës së autorëve evropianë dhe mekanizëm njëvjeçar për realizimin e prioriteteve të mëposhtme:

- *Prioriteti 1:*

Një ngjarje/festë njëditore në mbarë Evropën për të promovuar diversitetin e letërsisë dhe leximit evropian, duke përfshirë fushatë të fortë komunikimi nëpër vendet e Evropës Kreative në shkolla, biblioteka, librari dhe vende të tjera kulturore për t'i inkurajuar ata të organizojnë aktivitete leximi mbi baza vullnetare.

- *Prioriteti 2:*

Mekanizmi pilot evropian "autor në shkollë" për të lehtësuar dhe bashkëfinancuar takimet dhe shkëmbimet ndërmjet autorëve (ose përkthyesve) evropianë, të rinjve dhe/ose familjeve gjatë vitit shkollor. Mekanizmi mund të përfshijë autorë që vizitojnë shkollat, por edhe bibliotekat, libraritë apo vende të tjera të kapshme nga publiku. Në këto takime mund të marrin pjesë jo vetëm nxënësit, por edhe familjet e tyre.

- *Prioriteti 3:*

Ngritja e kapaciteteve – projekti duhet të shërbejë si platformë për shkëmbimin e praktikave të mira dhe mësimin e ndërsjellë për të promovuar leximin dhe letërsinë evropiane në nivel evropian. Ai duhet të forcojë rrjetëzimin midis organizatave që promovojnë leximin në Evropë, por gjithashtu të ndihmojë dhe stimulojë bashkëpunimin midis sektorëve të promovimit të librit, arsimit dhe leximit në vendet e origjinës, si dhe në të gjithë vendet e Evropës Kreative..

Mënyra e përgatitjes dhe dorëzimit të propozimit-projektit/aplikacionit

- Thirrjen dhe anekset mund t'i gjeni në këtë link:  
[Call for proposals for the organisation of a European reading promotion initiative: the Day of European Authors | Culture and Creativity](#)
- Propozim-projekti përgatiten sipas kushteve dhe kriterëve në dokument për thirrjen që mund ta merrni në këtë link:  
[Call Document EAC-S15-2024 Day of European authors.pdf](#)
- Aplikacionet përpunohen dhe dorëzohen në mënyrë elektronike nëpërmjet Funding &Tenders Opportunity Portal (F&TP). Informacione për qasje në F&TP mund të gjeni në këtë link:  
[https://www.eacea.ec.europa.eu/grants/how-get-grant\\_en](https://www.eacea.ec.europa.eu/grants/how-get-grant_en)